

Zyra e Këshillimit të Karrierës, Alumn-it në bashkëpunim me zyrën e Standarteve dhe Kurrikulave zhvilluan një takim me përfaqësues të Zyrës së Punës, me qëllim informimin e studentëve të programeve master në lidhje me shërbimet që ofron Agjencia Kombëtare e Punësimit, sa i takon programeve të punësimit, nxitjes së punësimit, programeve të praktikave profesionale, si dhe programeve të tjera të ofruara nga kjo Agjenci, me qëllim njohjen dhe orientimin e studentëve dhe pedagogëve me kërkesat dhe nevojat e tregut të punës, si nxitës edhe për përmirësimin e standarteve dhe kurrikulave.

Në këtë takim morën pjesë studentë të ciklit master, studentë të punësuar për të rrëfyer eksperiencën e tyre të punësimit, pedagogë përfaqësues nga çdo fakultet.



